



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Komunitete

Nr. 02-060/01-0038821-1/25 dt. 14.07.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete
Seanca e 42-të

Koha: 14.07.2025 ora 15:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Jeton Rrahmani, Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari, Esat Krasniqi, dhe Anesa Collaković

Mungoi: Habib Hajdini

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Z. Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot është thirrur mbledhja e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Diskutim për organizimin e trajnimeve profesionale për komunitetet në funksion të zhvillimit të tyre ekonomik dhe social (nga aktivitetet e parapara nga DKRS)

Rendi i ditës u miratua unanimit

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht.

Pika 2

Zv. Kryesuesja e Komitetit znj. Elidiana Budini Haziri theksoi se në këtë mbledhje ka qenë i ftuar edhe Drejtori i DKRS-së z. Fahri Jashari, i cili për shkak të disa problemeve shëndetësore nuk ka mundur të marr pjesë në këtë mbledhje. Ideja e kësaj pike ka qenë që data 15 korrik shënon Ditën Botërore të zhvillimit profesional për komunitetet jo shumicë. Do të ishte mirë që në planin e punës së DKRS-së për vitin vijues të parashihen aktivitete ose trajnime profesionale për këto komunitete përmes OJQ-ve në funksion të zhvillimit të tyre ekonomik dhe social.

Jeton Rrahmani: Pjesëmarrja e komuniteteve jo shumicë në aktivitete që organizohen si nga DKRS-ja e ashtu edhe nga shoqëria civile, është e kënaqshme, ne si Komitet për Komunitete do ta japim kontributin tonë në këtë drejtim, do të flasim me të rinj e të reja nga ky komunitet që të jenë më të angazhuar, por prapë po e përsëris që pjesëmarrja e tyre në aktivitete është goxha e mirë.

Zv. Kryesuesja e Komitetit znj. Elidiana Budini Haziri: Unë propozoj që ne si Komitet për Komunitete t'i rekomandojmë DKRS-së që në planin e punës së saj për vitin vijues të parashihen aktivitete ose trajnime profesionale për këto komunitete përmes OJQ-ve në funksion të zhvillimit të tyre ekonomik dhe social.

Komiteti për Komunitete unanimitisht e përkrahi propozimin e znj. Elidiana Budini Haziri.

Mbledhja përfundoj punimet në ora 15:30 min.

Mitrovicë
14.07.2025

Procesmbajtës:

Merita PRETENI

Kryesuesi i Komitetit

Jeton RRAHMANI